

	POLITIKA E CILËSISË		DT-003
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 1 nga 1

POLITIKA E CILËSISË

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) është e specializuar për menaxhimin e projekteve të arsimit, organizimin e trajnimeve nga fushëveprimi i vet, konsulencë në fushën e arsimit, publikime në fushën e arsimit.

Qëllimi ynë është ofrimi i shërbimeve cilësore që i përmbushin plotësisht kërkesat e klientëve tonë, sigurimi i një gjendjeje të qëndrueshme financiare dhe përmbushja e objektivave dhe interesave të organizatës.

Nëpërmjet zbatimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë sipas standardit ISO 9001:2015, do të arrijmë përmbushjen e pritshmërisë së përfituesve, donatorëve, partnerëve, klientëve, Bordit të KEC, punonjësve dhe shoqërisë.

Për të arritur qëllimin tonë menaxhmenti dhe punëtorët e KEC janë të obliguar që të:

- përmbushin kërkesat e përfituesve, klientëve, donatorëve, partnerëve dhe kërkesat specifike të projekteve,
- veprojnë sipas përgjegjësive të ndara dhe procedurave të përcaktuara,
- përmbushin në vazhdimësi kërkesat që dalin nga Standardi,
- përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e proceseve të punës,
- zhvillojnë në vazhdimësi aftësitë e personelit,
- veprojnë në mënyrë preventive me qëllim të evitimit të jokonformiteteve,
- njohin, zbatojnë dhe rishikojnë politikën e menaxhimit të cilësisë,
- përkushtohen maksimalisht në përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë,

Obligimet e vendosura mund të arrihen vetëm me dije, profesionalizëm, përvojë dhe motivim të punonjësve tonë, ngritje të aftësisë së tyre, gjithashtu edhe me përcjelljen e zhvillimit teknologjik dhe kërkesave të tregut.